

	KONKURS PUBLIK	DT-BNJ-027
	<i>ver. 1.1</i>	<i>faqe 1 nga 2</i>
Departamenti i Burimeve Njerëzore		Sektori i Personelit

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të punës nr. 03/L-212 të Republikës së Kosovës, nenin 4 (paragrafi 1, 2, 3, 4, 5) dhe nenin 5 të Udhëzimit Administrativ 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik si dhe pikën 4.4, 5.1.1, 6.2 dhe 9.2 të Politikës së Rekrutimit, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT sh. a. shpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e pozitës së lirë të punës:

Vozitës i Kryeshefit Ekzekutiv (1 kryes)

Kushtet e përgjithshme:

Kohëzgjatja e punësimit: Për kohë të pacaktuar.

Në tekstin në vijim përdorimi e njëres gjini nuk përjashton gjininë tjetër.

Orari i punës: Puna me orar të plotë. Lartësia e pagës do të përcaktohet në harmoni me politikat e aprovuara të KOSTT-it.

Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën: Vozitës i Kryeshefit Ekzekutiv (1 kryes)

Nr. referues i pozitës: 1.0.0.2

Detyrat e përgjithshme

Detyra e vozitësit të Kryeshefit Ekzekutiv është që të mbështes Kryeshefin Ekzekutiv në organizimin e itinerarit dhe kryerjen e shërbimit të vozitjes të KE me qëllim të realizimit të të gjitha çështjeve zyrtare për pjesëmarrje në takimet zyrtare dhe ngjarjet tjera zyrtare jashtë objektit të KOSTT-it.

Vozitësi i KE ofron shërbimin e vozitjes për Kryeshefin Ekzekutiv në institucionet përkatëse në destinacionet si brenda vendit ashtu edhe jashtë vendit kur paraqitet nevoja.

Detyrat specifike:

- Organizoj planifikimin e itinerarit
- Vozis Kryeshefin Ekzekutiv në takime dhe ngjarje zyrtare
- Të kryej shërbimin e vozitjes për KE nga aeroporti dhe anasjelltas si dhe në destinacionet tjera sipas nevojës dhe kërkesës së punës
- Kryen shërbimin e vozitjes për KE në takimet e institucioneve dhe te palët e interesit sipas porosisë dhe kërkesës së punës
- Të përdor veturën ekskluzivisht për udhëtime zyrtare të KE në pajtim me porosinë e KE
- Të vozis KE si brenda dhe jashtë Kosovës sipas nevojës
- Kujdeset që vetura të mirëmbahet me rregull, të pastrohet dhe të mbushet rregullisht me karburant
- Rregullisht mban evidencën për kilometrat e kaluara dhe karburantin e harxhuar
- Të kontrollojë veturën për sasinë e vajit, ujit, frenave, dritat, gomat etj. si dhe të kujdeset për riparime në rast nevojë
- Pas kthimit nga udhëtimet zyrtare mbyll urdhrin e punës, shënon kilometrazhin dhe parkon veturën në vendin e përcaktuar në parking

Të tjera

- Kryen edhe detyra të tjera të cilat kërkohen nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe që janë të nevojshme për funksionimin efektiv të KOSTT-it.
- Punon në auto park kur nuk vozitë.

Kualifikimet, aftësitë dhe shkathtësitë tjera të Vozitësit të Kryeshefit Ekzekutiv:

Kandidatët/et përveç kushteve të përgjithshme të punësimit të cilat kërkohen me ligj, duhet ti plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë përgatitjen e mesme shkollore
- Të posedoj patentë shoferin-kategoria B/BE (e domosdoshme) së paku prej 5 vitesh, ndërsa kategoritë tjera janë të preferueshme
- Të ketë së paku 5 vite përvojë pune në vozitje apo punë të ngjashme që përfshijnë vozitje të automjeteve dhe/ose transfer të asetëve
- Besueshmëria dhe përpikëria në punë dhe ruajtja e konfidencialitetit
- Aftësi të mira të komunikimit
- Të jetë i gatshëm të punoj edhe jashtë orarit dhe në vikende sipas nevojës
- Të jetë i gatshëm të punoj në kushte të ndryshme klimatike

Kushtet e punës: Jashtë KOSTT-it sipas nevojave të punës

Vendi/Lokacioni: Selia Qendrore e KOSTT-it

Forma e aplikimit për pozitën e shpallur:

Të interesuarit mund të aplikojnë përmes internetit duke i plotësuar aplikacionet të cilat mund t'i shkarkojnë nga Web Faqja e KOSTT-it: www.kostt.com

E-mail adresa ku duhet të aplikohet është: punesimi@kostt.com

Aplikacionet do të pranohen vetëm nga kandidatët, të cilët i plotësojnë kërkesat e parashtruara si në konkursin publik të shpallur në mjetet e shkruara të informimit dhe në web faqen zyrtare të KOSTT-it.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e diplomës së shkollimit si dhe kopjet e dëshmive tjera sipas kërkesave të konkursit.

Dokumentet origjinale të cilat i vërtetojnë faktet e theksuara në aplikacion duhet të prezantohen në momentin e intervistimit ose para intervistimit nëse kërkohen.

Selektimi i kandidatëve që plotësojnë kushtet e konkursit, testimi me shkrim, intervista, përzgjedhja dhe informimi i kandidatëve do të bëhen në përputhje me afatet dhe kriteret sipas udhëzimit administrativ për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nr.07/2017.

Konkursi publik mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në mjetet e shkruara të informimit dhe në web faqen e KOSTT, nga data 26.05.2023 deri me datën 09.06.2023 ora 24:00.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.